



Lajmet e Fundit:

DVP Durrës – Ushtronte aktivitetin në subjektin e tij, pas orarit të përcaktuar për mbyllje, ndëshkohet me masë administrative pronari



Lajmet

10/07/2021

Elbasan – Goditet një rast i armëmbajtjes pa leje, në pranga 1 shtetas

Goditet një rast i armëmbajtjes pa leje.
Sekuestrohen një armë zjarri automatik dhe municion luftarak, vihet në pranga poseduesi i tyre.
Specialistët për Hetimin e Krimin në Komisariatin e Policisë Elbasan në vijim të punës për rritjen e parametrave të sigurisë, si rezultat i kontrolleve të shtuara dhe në bazë të informacioneve të siguruar në rrugë operative se një shtetas posedonte armë zjarri pa leje në banesë, kanë ushtruar kontroll në banesën e shtetasit R.Ç në fshatin Xibrakë, Elbasan.
Si rezultat i kontrollit, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak.
Në përfundim të veprimeve është bërë dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit R. Ç., 64 vjeç, banues në fshatin Xibrakë, Elbasan dhe materialet hetimore i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprime të mëtejshme për veprën penale “Armëmbajtja pa leje”.

WhatsApp Share

Facebook Share

Twitter Share

LinkedIn Share

Email

◀ Manzë/Durrës – Arrestohen në flagrancë 2 pronarë objektsh, pasi u konstatuan duke ndërtuar pa leje

Tiranë – Bien në prangat e Policisë 12 shtetas, për vepra të ndryshme penale ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)